



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 4615 Prot.

Dt. 19.06.2026

PROJEKT-VENDIM

NR .DATE 19.06.2026


“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TE PARE TË PBA 2027-2029”


Mbështetur në nenin 9 pika 1.3 dhe neni 41 të ligjit nr 139/2015, “Per Vetëqverisjen Vendore”, në nenin 36 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit 9936 dt. 26.06.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” të ndryshuar; , ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhezimin Nr.23 date 30.07.2018, “Për procedurat standarte të pergatitjes së programit buxhetor afatmesem të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria Ekonomike;


- Ju paraqesim për diskutim e miratim,

1. Të miratojë Dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 (Faza I) për Bashkinë Roskovec dhe njesisë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave bashkëlidhur sic dhe janë ngarkuar në SMFV:
 - a. Raporti PBA1: Tavanet Pergatitore të PBA
 - b. Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
 - c. Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
 - d. Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III I COFOG)
 - e. Raporti PBA5: Shpenzimet sipas programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - f. Raporti PBA6: Deklarata e Politikës së programit
 - g. Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të programit
 - h. Raporti PBA8: Projektet e Investimeve
 - i. Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV / PROGRAMIN
2. Raporti i Doktrina e Dokumentit të PBA Vendor 2027-2029(Relacion)

2. Ngarkohen ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2027-2029 sipas këtij dokumenti .

Konceptoi: O.Goga 

Konfirmoi: D.Hoxha 

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo 

KRYETAR
Majlinda BUFI



Nr. UG 15/1 Prof.
Dt. 19.06.2026

Relacioni i përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029
BASHKIA ROSKOVEC, QARKU FIER

Tabela lëndës

1. Vështrim i përgjithshëm	
1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore.....	
1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë Roskovec, Qarku Fier.....	
1.3 Informacion financiar Kryesor	
2. Orientimi afatgjatë i bashkisë (relacion i shkurtër për bujqesinë)	
2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale.....	
2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit / Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit	
2.3. Plani i shpenzimeve kapitale 2027-2029	
Paraqitja e projekteve kryesore të investimeve për periudhën afatmesme.....	
3. Informacion financiar	
3.1 Burimi i të ardhurave.....	
3.2 Shpenzimet	
3.3 Informacion financiar suplementar	
3.3.3 Treguesit financiarë	

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njesisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia Roskovec si çdo njësi e qeverisjes vendore ka për qëllim të shërbejë qytetarëve nëpërmjet shërbimeve publike klasifikuar këto me programe të ndryshme buxhetore. Misioni kryesor i Bashkisë Roskovec fokusohet në rritjen e standarteve të shërbimeve publike, ofrimin e tyre me sa më shumë cilësi për të ofruar një qytet të mirëshërbyer në infrastrukturën publike në shërbime të ndryshme në arsim si dhe në shtresat në nevojë. Rritja e cilësisë në shërbime për ujitjen e kullimit, për sportin, kulturën, bujqësinë, shërbimin e MZSH-së, etj. Çdo veprim i saj ka në bazë parimin e autonomisë vendore. Për të realizuar këtë bashkia Roskovec ka hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor, Strategjinë e Zhvillimit Institucional në përputhje me misionin dhe vizionin e saj të detajuar, bazuar kjo në projekt idenë e titullarit dhe të drejtuesve të tjerë si dhe Programin Buxhetor Afatmesëm i cili konkretizon të gjithë këta dokumenta të rëndësishëm.

Vazhdimisht Bashkia Roskovec ka ndërmarrë investime në përputhje me objektivat strategjike të PPV-së dhe vazhdon të planifikojë investime të tjera në PBA-në dhe Buxhetin Vjetor.

Objektiva të tjerë të Bashkisë në zbatim të funksioneve të saj janë disa:

- Përmirësimi i kushteve të jetesës së qytetarëve.
- Mbulim sa më i plotë i territorit të saj me shërbime sa më cilësore.
- Përmirësim i infrastrukturës urbane dhe rurale përfshirë dhe atë turistike.
- Përmirësimi i shërbimit të pastrimit duke e shtrirë në të gjithë territorin që mbulon.
- Ofrimi i shërbimeve të tjera sipas nevojave të komunitetit.
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara dhe mbrojtja e mjedisit.
- Përmirësim i arsimit parauniversitar dhe mbështetja e edukimit profesional.
- Shtimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive për të gjithë grup moshat.
- Zhvillimi dhe mbështetja e zonave të biznesit.
- Promovimi dhe marketimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale.
- Mirëmbajtje e tregjeve publike si dhe ndërtimi i tregjeve të reja.
- Përmirësimi i transportit urban dhe zgjerimi i linjave rreth-qytetase.
- Mbështetja e shtresave në nevojë, si dhe përfshirja në politika e programe sociale.
- Sigurimi i një infrastrukture të nevojshme për një ndërhyrje sa më të shpejtë në rastet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.
- Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes dhe kullimit dhe rritja e cilësisë dhe sasisë së sipërfaqeve të shfrytëzueshme.
- Mbrojtja dhe shtimi i sipërfaqeve pyjore.
- Etj.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë Roskovec, Qarku Fier

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në fushën e Bujqësisë përmes shërbimit të ofruar nga sektori i Këshillimit Bujqësor me qëllim nxitjen e zhvillimit bujqësor të qëndrueshëm dhe arritjen e standardeve.
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e rrjetit të kullimit dhe ujitjes.
- Rritja e numrit të tregjeve në bashki, përmes krijimit të tregjeve rajonale dhe vendore.
- Hartimi i itinerareve turistike përmes identifikimit, inventarizimit dhe hartimit të burimeve natyrore dhe historiko-kulturore dhe lidhjes së tyre me itineraret rajonale.

- Promovimi i itinerareve turistike përmes krijimit të partneriteteve me operator aktiv në sektorin e ekoturizmit.
- Hartimi dhe zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në funksion të mbrojtjes së tokës bujqësore, krijimit të hapësirave cilësore urbane .
- Lehtësimi i aksesit të Njësive Administrative të bashkisë përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore lidhëse mes njësive administrative, qendrës së bashkisë dhe njësive fqinje.
- Rijetësimi i qëndrave të njësive administrative.
- Ngritja e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta .
- Fuqizimi i infrastrukturës shëndetsore.

1.3 Informacion financiar Kryesor

Të ardhurat:

(në lekë)

Për vitin 2027 Bashkia Roskovec ka planifikuar që do të gjenerojë 743,202,379 lekë

Për vitin 2028 Bashkia Roskovec ka planifikuar që do të gjenerojë 750,448,379 lekë

Për vitin 2029 Bashkia Roskovec ka planifikuar që do të gjenerojë 760,038,494 lekë

Shpenzimet: (në mijë lekë)

Në përputhje me të ardhurat e realizuara janë të pozicionuara edhe shpenzimet dhe përsa i përket strukturës së shpenzimeve kemi këta tregues:

Për vitin 2027 Bashkia Roskovec ka planifikuar që të shpenzojë 743,202,379 lekë.

Shpenzimet e parashikuara do të jenë 390,822,487 lekë për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore ose 52.58 % të totalit të shpenzimeve, 109,430,296 lekë ose 14.73 % do të jenë për shpenzime operative dhe 242,949,596 lekë ose 32.69 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara do të jenë për shpenzime kapitale.

Për vitin 2028 Bashkia Roskovec ka planifikuar që të shpenzojë 750,448,379 lekë.

Shpenzimet e parashikuara do të jenë 395,305,580 lekë për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore ose 52.68 % të totalit të shpenzimeve, 110,685,562 lekë ose 14.75 % e totalit të shpenzimeve do të jenë për shpenzime operative dhe 244,457,237 lekë ose 32.57 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara do të jenë për shpenzime kapitale.

Për vitin 2029 Bashkia Roskovec ka planifikuar që të shpenzojë 760,038,494 lekë.

Shpenzimet e parashikuara do të jenë 398,305,580 lekë për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore ose 52.41 % të totalit të shpenzimeve, 111,525,562 lekë ose 14.67 % e totalit të shpenzimeve do të jenë për shpenzime operative dhe 250,207,352 lekë ose 32.92 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara do të jenë për shpenzime kapitale.

Raporti: PBAI - Tavanet Përgatitore të PBA 2027-2029

	2027	2028	2029
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			
Shpenzime Personeli (600-601)	105,800	107,863	108,956
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	42,467	42,667	42,667
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	1,500	1,500	1,500
Tavanet e Përgjithshme	149,767	152,030	153,623
03040 - Shërbimet e Policisë Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	6,417	6,574	7,374
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0

Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	6,417	6,574	7,374
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			
Shpenzime Personeli (600-601)	22,258	23,258	24,563
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	4,507	4,507	4,510
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	26,765	27,765	29,073
04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëveit			
Shpenzime Personeli (600-601)	8,783	8,783	8,983
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	8,783	8,783	8,983
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit			
Shpenzime Personeli (600-601)	13,944	13,944	13,944
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	9,994	12,820	12,820
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	23,939	26,764	31,443
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave			
Shpenzime Personeli (600-601)	3,489	3,589	3,489
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	500	500	500
Tavanet e Përgjithshme	3,989	4,089	3,989
04520 - Rrjeti Rrugor Rural			
Shpenzime Personeli (600-601)	25,117	24,498	23,861
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	7,436	7,436	7,436
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	196,450	197,957	202,828
Tavanet e Përgjithshme	229,003	229,891	234,125
05100 - Menaxhimi i mbetjeve			
Shpenzime Personeli (600-601)	29,939	30,241	30,052
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	14,963	15,063	15,163
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	1,500	1,500	1,200
Tavanet e Përgjithshme	46,402	46,804	46,415
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika			
Shpenzime Personeli (600-601)	12,518	12,999	13,526
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	12,518	12,999	13,526
06260 - Shërbimet Publike Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	37,897	38,897	38,897
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	11,000	9,130	9,867
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	2,000	2,000	2,000
Tavanet e Përgjithshme	50,897	50,027	50,764
08130 - Sport dhe argëtim			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	18,000	17,000	12,000
Tavanet e Përgjithshme	18,000	17,000	12,000

08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat			
Shpenzime Personeli (600-601)	13,815	13,815	13,815
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	5,500	5,500	5,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	3,000	3,000	3,000
Tavanet e Përgjithshme	22,315	22,315	22,315
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)			
Shpenzime Personeli (600-601)	79,267	79,267	79,267
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	10,019	10,019	10,019
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	15,000	16,000	17,000
Tavanet e Përgjithshme	104,287	105,287	106,287
09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm			
Shpenzime Personeli (600-601)	3,735	3,735	3,735
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	3,735	3,735	3,735
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët			
Shpenzime Personeli (600-601)	27,841	27,841	27,841
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,200	1,200	1,200
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	29,041	29,041	29,041
10661 - Strehimi social			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	5,000	5,000	5,000
Tavanet e Përgjithshme	5,000	5,000	5,000
04910 - Fondi Rezerve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,743	1,743	1,743
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	1,743	1,743	1,743
04940 - Fondi Kontigjence			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	600	600	600
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	600	600	600
Totali i Shpenzime Personeli (600-601)	390,822	395,306	398,306
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	109,430	110,686	111,526
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	242,950	244,457	250,207
Tavanet e Përgjithshme	743,202	750,448	760,038

Gjatë punimit të Projekt-Buxhetit Afatmesëm për periudhën 2027-2029 kemi realizuar degjese publike ne qytetin Roskovec dhe ne Njesitë Administrative për përcaktimin e prioriteteve të investimeve kapitale dhe shërbimeve publike në kuadër të hartimit të PBA 2027-2029. Keto degjese shërbejnë si një instrument kyç për të orientuar fondet publike drejt nevojave reale dhe emergjente të komunitetit, duke garantuar transparencë dhe një shpërndarje të balancuar të investimeve në të gjithë territorin.

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

Bashkia do të synojë forcimin e rolit ekonomik të saj në rajon, si qendra e zhvillimit bujqësor. Zhvillimi i këtij sektori do të bëhet përmes promovimit të teknikave të prodhimit të produkteve organike dhe cilësore, etiketimit dhe marketimit të tyre, duke synuar rritjen e prezencës së tyre në tregjet vendase dhe ato të huaja. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore e blegtorale do të bëhet në mënyrë të qëndrueshme, duke u kujdesur për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe burimet e tjera natyrore me qëllim garantimin e mirëqenies sociale të qytetarëve ekzistues dhe brezave të ardhshëm.

Vëmendje i është kushtuar rrugëve kryesore, sidomos në njësitë Administrative dhe në lagje të qytetit.

Gjithashtu në vite është parashikuar si pjesë e buxhetit, ashtu si çdo vit, edhe mirëmbajtja e rrugëve bujqësore ose hapja e rrugëve të reja, por të raportuara në programet e tjera të PBA-së.

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale

Në përmbushje të vizionit të Bashkisë Roskovec, janë hartuar 3 objektiva strategjike afatgjatë kryesore mbi të cilat mbështetet dhe hartimi i PBA-së.

Objektivi Strategjik 1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë/blegtorisë dhe agropërpunimit, si sektor kryesor të ekonomisë dhe punësimit.

Objektivi strategjik 2: Kontrolli i zhvillimit të territorit nëpërmjet harmonizimit të nevojave të banorëve ekzistues dhe të planifikuar.

Objektivi strategjik 3: Mbrojtja e burimeve natyrore si baza për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit / Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit

Sfidat kryesore të zhvillimit për Bashkinë Roskovec fokusohen në rritjen e zhvillimit ekonomik por jo vetëm. Qëllimet kryesore të Bashkisë Roskovec nuk mund të realizohen pa një qasje të mirëorganizuar të disa komponenteve të cilët po i pasqyrojmë më poshtë:

1. Zbatueshmëria e ligjeve të ndryshme me të cilat funksionon pushteti vendor.
2. Një administratë e kualifikuar dhe e mirëorientuar për këto objektiva.
3. Zbatimi me përpikmëri i menaxhimit financiar dhe kontrollit.
4. Matje e rezultateve dhe arritjet e periudhave etj.

Dhe ajo çka në fund synohet në sfidat e zhvillimit janë: Rritja e transparencës me qytetarët, qeverisja më e mirë por dhe më afër qytetarëve si dhe një qeverisje me një zbatueshmëri me përpikmëri ligjore.

2.3. Plani i shpenzimeve kapitale 2027-2029

Paraqitja e projekteve kryesore të investimeve për periudhën afatmesme

(000 leke)

Gr.	Kodi instituc	Emertimi investimeve sipas objekteve	Viti	Viti	Viti	Viti
			2026	2027	2028	2029
00	113002	Blerje Pajisje & Invest.tjera Bashkia	2,500	1,500	1,500	2,000
00	113002	Bashkefinansim per projektin Vendorsja e paneleve diellore prane stacionit te pompimit Hoxhenj Sukl	1,000			
00	113002	Shpronosim per projektin&Rritja e sigurise se diges dhe permiresimi I aftesise ujembledhese te Rezervuarit te Kurjanit	2,482			
00	113002	Makineri dhe pajisije pune	1,980			
00	113002	Pyllezim	500	500	500	500
00	113002	Shpronosime te bllokut nr 3	4,146	-		
00	113002	Ndertim i kanalit kullues dhe ndertimi i rruges lidhese mbi te	10,902			
00	113002	Rehabilitim I ish-bllokut te STM , Roskoves, Rruga nr.5 (Ismail Cepele),143 ml	3,993			
00	113002	Rikonstruksion I rruges Kozma Prifti, fshati Marinez,(905+265 ml , b=4m+0.5 bankin)	8,008			
00	113002	Rikonstruksion I rruges Siqeca (Kashte e bardhe), fshatiKurjan, 750 ml, (asfaltobeton 4 ml , bankin-5x0.5 m)	3,593			
00	113002	Asfaltim I rruges Lamaj , fshati Mbers, 1400 ml , b=4m	5			
00	113002	Asfaltim I rruges Para shkolles , fshati Suk 1, L=400+350 ml , b=4m+2x0.5 bankine	4,337			
00	113002	Asfaltim I rruges Priftanjaket , fshati Strum, L=800 ml , b=4m+0.5 bankine	3,547			
00	113002	Blerje cakull per rruge * *	2,574	*		*
00	113002	Investime ne rruget rurale dhe urbane te bashkise	92,684	104,749	197,957	202,828
00	113002	Rruge parcele ne fshatrat e NJA Roskovec,Strom,Kuman dhe Kurjan	2,087			
00	113002	Ndertim i rrugeve ne NJA Strum	34,300			
00	113002	Rruga "Buzallaret",400ml + rruga e "Doksaneve",150ml,fshati Kurjan,(b=4m rere bituminoze +2x0.5m Bankine)	4,607			
00	113002	Rikonstruksion I rruges "Zogallaret" , fshati Suk-2- 600 ml+ rruga "Asllan Toska 670 ml+rruget lidhese 189 ml,(shuma 1459 ml) (b=4m rere bituminize +2*0.5 m bankin)	3,751			
00	113002	Rikostruksion I rruges "Lagja Dortaj",fshati Vlosh,600ml	579			
00	113002	Rikonstruksion I rruges Vidhisht-Kerranjaket , fshati Lar- 2060 ml,(b=4m Rere bitminoze + bankine-2x0.5m)	1,639			
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën e Dulleshtit, L-1655		3,141	7,329	

		ml,Kurjan				
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën Braushaj,L=548 ML,Mbers	1,082	2,524		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën e Vloshit,L=1290ml	2,575	6,008		
00	113002	FAZA - 1: Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën NgjeqarKurtaj, Pik 1- 18, Progresivi 0 - 850 m	1,641	3,830		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën e shkolles + degezime, L=897 ml,Vidhisht	1,737	4,052		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën "Lami Metani", L=206 ml,Kuman	392	914		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike ne rrugën Izet Ruko,Marinez	910	2,122		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën File Hoxha+degezime te rruges se liqenit, L=1835 ml,Luar	3,666	8,554		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën Muskallarë, L= 514 ml ; rrugën e Çiflikut, L=1038 ml dhe rrethrotullimin SukStrum,Strum	3,278	7,649		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën Sakaj + degëzim, L=342 ml,Suk 1	667	1,557		
00	113002	Riveshje me shtresa asfalt në rr."Dervish Refati", L=143 ml,"Suk i Sipërm", L=89 m,Senkaj +degëzim, L=289 ml,"Asllan Toska" + degëzime, L=160 ml,Suk 2	1,306	3,048		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike në rrugën "Nexhip Xhaferri", L=311 ml,në rrugën e Dardhajve, L=257 ml,në rrugën e Yrtit, L=76 ml,Velmish	1,249	2,914		
00	113002	Ndertimi Bibloteka ne qytetin Roskovec	7,466	17,422		
00	113002	Riveshje me shtresa asfaltike ne rrugicat e lagjes Nr.1,L=1602 ml,Roskovec	5,592	13,048		
00	113002	Mbulim kanali ,L=250 ml,Fshati Kuman	1,693	1,088		
00	113002	Bashkefinancime per projekte me qeverine	1,500	1,500		
00	113002	Mbikqyerje dhe kolaudim punimesh	3,000	3,000		
00	113002	Sistemi I Ambienteve te poligonit, Roskovec	1,840	4,293		
00	113002	Sinjalistika rrugore e rruges"Todi Pipa", fshati Marinez	300	700		
00	113002	Blerje Asfalti per mirembajtje rruges	150	150		
00	113002	Kontinier dhe kosha per mbeturina	1,404	1,500	1,500	1,200
00	113002	Ndertimi i parkut te ri te qytetit	5,809			
00	113002	Blerje e 100 nanduesve me panele diellore	2,000	2,000	2,000	2,000

00	113002	Peme dekorative	240			
00	113002	Blerje materiale:"Ndertim KUZ Xhokenjt , fshati Strum L=1856 ml";	1,299			
00	113002	Blerje materiale:"Ndertim KUZ ne lagjen Limallaret+Toskallaret , fshati Suk2 L=985 ml";	1,223			
00	113002	Ndertimi i fushes se sportit me njesi tregtare	16,571			
		Kompleksi I tereneve sportive te hapura dhe te mbyllura ne shkollen 5Deshmoret, Suk1,Bashkia Roskovec	5,957			
		Riparime ne memorialin dhe 2 shatervanet e qytetit	2,027			
		Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "5 Deshmoret" + kopesht,Suk 1,ambjente sportive dhe ndertim i palestres	431			
		Rikonstruksion I shkolles 9- vjecare 5 Deshmoret + kopesht Suk1 ambjente sportive dhe ndertimi palestres(1130372)	10,172			
		Rikonstruksion ne shkollat nen administrim te bashkise		13,000	16,000	17,000
		Bashkefinansim restaurimi godines se kopshtit jagodine dhe zyres se pleqesise	1,998			
		Restaurim Shkolla Arapaj	2,000	2,000		
		Kontribut per investime ne banesat sociale	9,248	5,000	5,000	5,000
		Hartim studim fizibiliteti	350			
		Projektues per hartimin e projektit Ndertim i Bibliotekes se Re	516			
		Qeverisje e mire permes pjesemarrjes aktive ne bashkefinansimin e projekteve,rehabilitimi i rruges se Liqenit,Roskovec	3,000			
		Rikonstruksion dhe ndertim i infrastrukturës publike				4,679
		Ndertimi i fushes se sportit faza 2		18,000	17,000	12,000
		Rikonstruksione ne monumete kulturore		3,000	3,000	3,000
		Shuma e investimeve	296,643	242,950	244,457	250,207

Nisur nga prioritetet si dhe nga nevojat e paraqitura pjesa më e madhe e investimeve është adresuar në njësitë administrative, për tu ardhur në ndihmë banorëve të këtyre zonave, me qëllim lehtësimin e jetesës së tyre, lehtësimin e lëvizjeve për në qytet si dhe midis vetë njësive. Këto janë disa projekte me një shtrirje gati 1-2 vjeçare (2027-2029)

Pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë të parashikuara që në buxhetin e vitit 2027 dhe kanë një shtrirje deri në vitin 2028 dhe 2029, po që gradualisht, sipas mundësive dhe nevojave do të plotësohen me investime të tjera gjatë viteve në vazhdim.

Një pjesë e investimeve mbetet për tu parë gjatë zbatimit të buxhetit pasi mund të lindin edhe nevoja për ndryshime, apo rishpërndarje për shkak të metodologjive të re, kostifikimit të produkteve.

3. Informacion financiar

3.1 Burimi i të ardhurave

Analizë për parashikimin e të ardhurave për periudhën 2027-2029 (Faktorët e rritjes ose uljes së nivelit të mbledhjes së taksave/tarifave)

Në planifikimin e të ardhurave afatmesme vendore bazë është paketa fiskale e miratuar në vitin 2025 për vitin 2025 në bazë të të gjithë legjislacionit në fuqi, ndërsa në planifikimin e transfertave të pakushtëzuara është marrë parasysh fondi i përlogaritur për vitin 2026 si dhe niveli i rritjes që jepet në udhëzimin plotësues nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029". Në planifikimin e të ardhurave vendore afat mesme është mbajtur parasysh realizimi i viteve të mëparshme.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Roskovec, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Paketa fiskale e Bashkisë Roskovec për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësisve administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj.

Proçesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me GMS (administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë etj). Vazhdimi i këtij proçesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.

Realizimi i këtyre të ardhurave ka dhe rrisqet e veta. Ky rrisq më i madh është në mbledhjen e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore nga mos saktësimi i pronës.

Bashkia është në punë të vazhdueshme për minimizimin e rrisqut dhe rritjen e të ardhurave.

3.2 Shpenzimet

Analizë për parashikimin e shpenzimeve për periudhën 2027-2029 (Faktorët e rritjes ose uljes së shpenzimeve të personelit/operative/investime).

Në planifikimin e këtyre shpenzimeve kemi pasur parasysh planifikimin e të ardhurave për vitet 2027-2029 miratuar me VKB nr.21 datë 26.02.2026, rritjen e transfertës së pakushtëzuar, dhe të

ardhurat e trashëguara. Për transfertën e pakushtëzuar sektoriale niveli i parashikuar do të jetë ai i vitit 2027 edhe për dy vitet në vazhdim 2028, 2029.

Në planifikimin e shpenzimeve numrin e programeve e kemi sipas shtojces 5, në zbatim të Udhëzimit nr.7 datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”. Në përputhje me këtë bashkia shpenzimet i ka klasifikuar në 20 programe, bashkë me fondin rezervë dhe të kontigjences, te cilet janë: 1. Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi, 2. Shërbimet e Policisë Vendore, 3. Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, 4. Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve, 5. Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit, 6. Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave, 7. Rrjeti Rrugor Rural, 8. Menaxhimi i mbetjeve, 9. Strehimi lokal dhe urbanistika, 10. Shërbimet Publike Vendore, 11. Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime, 12. Shërbimet e Kujdesit Paresor, 13. Sport dhe argëtim, 14. Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat, 15. Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin), 16. Arsimi i mesëm i përgjithshëm, 17. Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, 18. Strehimi social, 19. Fondi Rezerve, 20. Fondi Kontigjence.

Shpenzimet korrente (Pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative) nga njëri vit në tjetrin kanë një rritje të ulët, kurse shpenzimet kapitale kanë rritje të ndryshme në vite të ndryshme dhe pesha specifike e tyre ka ardhur në rritje, që shërben njëkohësisht edhe si tregues pozitiv. Detyrimet e papaguara janë të përfshira sipas programeve dhe kjo pjesë është e ndryshueshme në varësi të rezultateve konkrete të çdo viti.

3.3.3 Rreziqet financiare dhe fiskale

Vlerësimi i rreziqeve financiare e fiskale dhe masat për zvogëlimin e rrezikut.

Analiza dhe trajtimi i rreziqeve është puna më domethënëse dhe më frytdhënëse gjatë hartimit të dokumentave bazë të funksionimit të një institucioni (Rregullorja e brendshme, plani i zhvillimit strategjik, programi buxhetor afatmesëm, etj), si dhe me tej gjatë zbatimit dhe monitorimit të tyre. Menaxhimi i këtyre rreziqeve në vetvete do të thotë të identifikosh, vlerësosh dhe kontrollosh ato situata të cilat ndikojnë negativisht në arrijten e objektivave të drejtorive. Kur themi “Objektiva”, konkretisht i referohemi objektivave afatmesme (PBA) të cilat përkthehen deri në plane vjetore operacionale të drejtorive të bashkisë. Për menaxhimi me fokus në rrezik është instrumenti kryesor që con në arrijten e objektivave vjetore dhe më tej të PBA 2027-2029.

Bashkia Roskovec si çdo institucion tjetër i qeverisjes vendore dhe qendrore ka një sistem të vendosur të Menaxhimit dhe Kontrollit, të cilin përpiqet vazhdimisht për ta përmirësuar në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Treguesit e performancës së buxhetit dhe menaxhimi i riskut mbeten fushat më të vështira brenda kornizës së kontrollit të brendshëm për bashkinë. Kjo do të thotë që vëmendja kryesore e çdo hallke drejtimi dhe çdo funksion kontrolli duhet të fokusohet në menaxhimin e punës dhe kërkesën e llogarisë mbi bazën e risqeve të identifikuar më parë, dhe mbi të gjitha në parashikimin realist të të ardhurave të bashkisë, përdorimin me efektivitet të fondeve vendore dhe menaxhim sa më të mirë të situatave financiare.

Grupi për Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut, miratuar nga Kryetarja me Urdhër Nr. 52 dt. 10.02.2025, kryesohet nga Koordinatorin e deleguar të riskut dhe përbëhet nga 12 përfaqësues të drejtorive kryesore të bashkisë dhe njëkohësisht anëtare të ekipeve të programeve buxhetore. Grupi mbledhet në referencë me kalendarin e hartimit të PBA-së dhe njëherë në 6 muaj, nëse ka ndryshime thelbësore në mjedisin e riskut, përgatit një informacion me shkrim lidhur me monitorimin e risqeve, të cilin ia përcjell Kryetares. Monitorimi dhe raportimi në vazhdimësi ndihmon në evidentimin e faktit nëse risqet e evidentuara janë menaxhuar me sukses, nëse

aktivitete e kontrollit ulin realisht riskun dhe nëse objektivat e rrezikuara janë realizuar. Në këtë mënyrë sigurohet transparenca dhe llogaridhënia për veprimtarinë e çdo drejtorie apo sektori.

Metodologjia e ndjekur për risqet e PBA 2027-2029 dhe lista e risqeve kryesore me masat për trajtimin e tyre.

Gjatë procesit të hartimit të dokumentit të PBA 2027-2029, janë zhvilluar takime të dedikuara me pjesëmarrjen aktive të koordinatorëve të riskut, nën mbikëqyrjen direkte të Kryetares së Bashkisë. Pas hartimit të deklaratave të programeve buxhetore me objektivat dhe treguesit përkatës të performancës, janë diskutuar risqet kryesore që mund të prekin realizimin e disa objektivave dhe produkteve të planifikuara, janë vënë në diskutim nënproçeset/aktivitetet që janë të nevojshme për të përmbushur ato, duke menduar për ndarjen e detyrave, kontrollet minimale të brendshme të nevojshme dhe rëndësinë për dokumentimin e të gjithë procesit.

Më pas, koordinatorët analizuan procedurat/kontrollet e tyre aktuale, vlerësuan rreziqet dhe përcaktuan masat që do të ndërmerren në të ardhmen për të cilat kërkohet vendimarrje në nivele të ndryshme të menaxhimit deri në Këshillin Bashkiak. Vendimarrja përfundimtare përcakton dhe pronarin ose zoteruesin e riskut, i cili me pas është përgjegjës për monitorimin e tij. Më pas u theksua rëndësia e monitorimit dhe raportimit mbi riskun, ku një rol të rëndësishëm në raportim luan drejtori përgjegjës i fushës që prek rreziku.

Theksi vihet në risqet që lidhen me planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave të bashkisë, sidomos për mbledhjen e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, nga mos saktësimi i pronës.

Buxhetimin gjinor

Buxheti gjinor nuk ka të bëjë vetëm me buxhetin dhe nuk është një veprimtari që kryhet një herë dhe konsiderohet i përfunduar por është një proces i vazhdueshëm që duhet të zbatohet në të gjitha nivelet dhe fazat e procesit të politikave.

Buxheti Gjinor ka të bëjë me formulimin e legjislacionit, politikave, planeve, programeve dhe skemave të ndjeshme ndaj gjinive dhe madje mund të quhet hallka më e rëndësishme e zinxhirit të integritetit gjinor. Pra thënë ndryshe, që një bashki të buxhetojë me baza gjinore nënkupton të ndërtojë politika, programe, strategji të cilat mbështesin dhe integrojnë gratë dhe vajzat në të gjitha hallkat e politikbërjes.

Madje një buxhetim i përgjegjshëm gjinor nënkupton të paturit një strategji që mundohet të matë ndikimin e politikave të bashkisë mbi gratë dhe burrat duke i balancuar dhe shpërndarë të ardhurat në mënyrë të tillë që shërbimet të shkojnë njëlloj të përfituara si nga burrat dhe gratë.

Një buxhetim i përgjegjshëm gjinor do të thotë të analizosh buxhetet vendore, duke i vlerësuar sa i përgjigjen ato nevojave të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, si dhe nëse ato kontribuojnë apo jo për rritjen e barazisë midis grave dhe burrave.

Një buxhet i balancuar gjinor nënkupton ofrimin e mundësive njësoj të aksesueshme si për meshkujt dhe për femrat duke mundësuar kështu zvogëlimin sa më shumë të pabarazisë gjinore. Normalisht për të hartuar një buxhet me qasje gjinore ka dhe sfidat e tij, dhe kjo në kuptimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore gjinore duke specifikuar kështu përfituesit e një funksioni të caktuar buxhetor. Një projekt i hartuar dhe më pas i vënë në zbatim në një zone të caktuar paraprkisht duhet të jetë i mirëstudiuar se cilët janë përfituesit e tij, sa i vjen në ndihmë dhe sa dobi sjell për ta.

Thënë ndryshe qëllimi kryesor i hartimit të një buxheti gjinor nënkupton hartimin e politikave të tilla që shërbimet dhe mundësitë të ofrohen njësoj të aksesueshme dhe të përfitueshme për të dyja gjinitë.

Një tjetër hap i ndërmarrë në promovimin dhe mbështetjen e buxhetimit gjinor është organizimi i aktiviteteve të ndryshme me fokus rritjen e vetëbesimit tek femrat madje edhe në ato raste ku fatkeqësisht hasen femra të dhunuara apo të nënshtruara. Kjo kategori është mbështetur shumë nga Drejtorja e Shërbimit Social, Bashkia Roskovec për motivimin dhe rritjen e vetëbesimit të tyre. Nëse besojnë në veten e tyre ato mund të jenë motorri i zhvillimit të shoqërisë.

Në Bashkinë Roskovec është punuar për një buxhet me të dhëna specifike statistikore gjinore në të gjitha funksionet buxhetore sipas përfituesve të funksioneve specifike. Funksionet konkrete të punuara me të dhëna statistikore gjinore janë:

- Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi
- Shërbimet e Policisë Vendore,
- Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile,
- Shërbimet Publike Vendore,
- Sport dhe Argëtim,
- Arsimi bazë përfshirë parashkollorin
- Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

Grupi i punës:

Drejtorja Ekonomike

Orgesa Goga

Drejtorja e Politikave Ekonomike dhe Promovimit

Enerida Kuqo

Drejtorja e Bujqesise

Viktor Kola

Drejtorja e Zhvillimit Rural

Agron Dardha

Drejtorja e Planifikimit

Samuela Plaka

Drejtorja e Shërbimit Social

Suela Cepele

Drejtorja të Ardhurave Vendore

Selman Cepele

Drejtorja e Mbrojtjes civile

Isa Hoxha

Drejtorja e B.Njerezore dhe Juridike

Vjollca Zeqo

Drejtorja e pastrimit

Miranda Cepele

Drejtor i Investimeve

Ermir Hajdini

Drejtor i Arsimit dhe Kultures

Brikena Cjapi

KRYETARI I BASHKISË

Majlinda Bufi

*Ni mungon e urdher
Z. KRYETARI
MAKSI M. GOGA*